

**VENDIM**  
**Nr. 448, datë 22.5.2013**

**PËR SIGURIMIN E JETËS SË USHTARAKËVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA, QË  
DËRGOHEN NË MISIONE USHTARAKE JASHTË VENDIT, PËR VITIN 2013**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5 të nenit 6 të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, të ndryshuar, të shkronjës “c” të pikës 2 të nenit 5 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ministria e Mbrojtjes, në bashkëpunim me shoqërinë e sigurimeve “INSIG” sh.a., të bëjë sigurimin e jetës nga aksidentet në grup të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, që dërgohen në misione ushtarake jashtë vendit për vitin 2013.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, miratuar për vitin 2013.

3. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes dhe shoqëria e sigurimeve “INSIG” sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**